



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR**

Data: 15.1.2025

Nr: 1

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 01, DATË 05.12.2020,
“PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E
VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË
NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "a", e 3, nenit 46, pikat 1 dhe 2, nenit 50, pika 3, neneve 52, 62, 93, nenit 108, pika 7 dhe nenit 109, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

VENDOSI:

Në Udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

- 1. Në pikën 3, të nenit 8, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “ose me mjete elektronike” sipas përcaktimeve të Komisionerit”.**
- 2. Neni 9, ndryshohet si më poshtë vijon:**

“Neni 9

Ndryshimi i vendndodhjes së qendrës së votimit

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në ambiente publike vetëm për arsye objektive sipas kriterëve të vendosura në Kodin Zgjedhor deri në periudhën 41 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në vendimin e tij, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të arsyetojë dhe dokumentojë shkaqet objektive të ndryshimit duke përfshirë një krahasim të qartë të kushteve mes vendndodhjes ekzistuese dhe asaj të re për sa i përket:
 - a. Vlerësimit të kushteve të infrastrukturës dhe aksesueshmërisë për zgjedhësit në

Data: 15.1.2025 Nr: 1
Ora: 12:00



“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar”

- ambientin ekzistues dhe atë të ri.
- b. Vlerësimet të kushteve të sigurisë të ambienteve së vendndodhjeve përkatëse (asaj ekzistuese dhe asaj të re).
 - c. Verifikimet të kapaciteteve të ambienteve për akomodimin e zgjedhësve.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon në KQZ vendimin shoqëruar me relacionin, i cili duhet të përmbajë të dhëna të qarta për gjendjen e ambientit ekzistues dhe atij të ri (propozuar), duke përfshirë edhe arsyet që diktojnë këtë ndryshim, të tilla si:
 - a. Dhënia e sqarimeve nëse vendndodhja e re ndodhet brenda të njëjtit territor kompakt dhe të pashkëputur gjeografik për zonën e QV-së.
 - b. Nëse vendndodhja e re e QV-së gjendet në një zonë tjetër qendre votimi duhet të specifikojë arsyet objektive për këtë ndryshim dhe nevojën që e dikton këtë ndryshim.
 - c. Distancën (në metra/ km) të vendndodhjes së re nga vendndodhja e mëparshme e QV-së si dhe nga zona ku banojnë zgjedhësit e QV-së.
 - ç. Të specifikojë arsyet objektive që çuan në ndryshimin e vendndodhjes, dhe të dokumentojë edhe me foto dhe të provojë arsyet që e kanë bërë të pamundur përdorimin e vendndodhjes së mëparshme të QV-së.
 3. Vendndodhja e qendrës së votimit (publik, privat) nuk mund të ndryshojë 40 ditë para datës së zgjedhjeve. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të kërkojë ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit me autorizim nga KQZ-ja vetëm për arsye të forcës madhore. Do të konsiderohen forcë madhore fatkeqësitë natyrore që dëmtojnë ose bëjnë të pamundur përdorimin e qendrave të votimit, problemet e papritura infrastrukturore që pengojnë procesin e votimit apo rrezikojnë sigurinë e votuesve dhe administratës zgjedhore në qendrat e votimit. Kërkesa për autorizimin e ndryshimit të vendndodhjes sipas këtij paragrafi shoqërohet me arsyetimin për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.
 4. Administrata e KQZ-së monitoron dhe vlerëson qendrat e votimit për të siguruar që ato përmbushin kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
 5. Në rastet kur administrata e KQZ-së konstaton se një qendër votimi ose ndryshimi i propozuar nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenet 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor dhe këtij udhëzimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për gjetjet dhe kërkon zgjidhje alternative brenda afatit të caktuar prej tij në njoftim. Nëse kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk paraqet propozime alternative, administrata e KQZ-së identifikon ambiente alternative (publike ose private) që plotësojnë standardet dhe përgatit një raport të detajuar për t'ja paraqitur Komisionerit.
 6. Komisioneri shqyrton në seancë publike raportin e administratës së KQZ-së dhe vendos për ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në një ambient alternativ. Në çdo rast vendndodhja e re e QV-së caktohet në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 93 pika 2 të Kodit Zgjedhor. Pas vendimit të KQZ-së, qendra e votimit nuk ndryshon.

3. Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore apo zyrtari që ushtron këtë funksion, menjëherë pas miratimit të listës së zgjedhësve, dërgon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, DPGJC dhe Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës, numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve, numrin e zgjedhësve me aftësi ndryshe, dhe të dhëna të tjera përfshirë edhe kërkesat e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi me shkresë ose në formë elektronike, sipas udhëzimeve të

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në rastin e ndryshimeve të vendndodhjes së qendrave të votimit deri 41 ditë para datës së zgjedhjeve dërgon në KQZ, DPGJC dhe në KZAZ, vetëm të dhënat për vendndodhjet që ndryshojnë, jo me vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. DPGJC duhet të pasqyrojë adresën e përcaktuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.”

2. Pika 3 shfuqizohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe organet e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar